



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1046, datë 17.11.2009

Për
caktim numeracioni sipërmarrësit “Neofone” shpk.

Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në mbledhjen e datës 17.11.2009, sipas rendit të ditës dhe procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme në fuqi, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 452, datë 02.05.2008, e ndryshuar me Vendimin nr. 746, datë 17.07.2009, bazuar në ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 115 “Marrja e Vendimeve dhe Struktura e Këshillit Drejtues”, mori në shqyrtim:

- Propozimin e Drejtorisë së Liçensimit për miratimin e kërkesës së sipërmarrësit “Neofone” shpk për caktim numeracioni.

BAZA LIGJORE :

- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 8 – pika j) dhe nenet 80 deri 90;
- “Rregullorja për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike dhe Planit kombëtar të numeracionit” miratuar me VKD Nr. 932, datë 11.08.2009.
- Rregullorja e brendshme e AKEP miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 170 datë 24.04.2004, e ndryshuar - neni 21, pika 17.

Ne përfundim të interpretimit të bazës ligjore dhe kërkesës së sipërmarrësit të sipërcituar, Këshilli Drejtues

V E N D O S I :

1. Te miratoje kërkesën e sipërmarrësit “Neofone” shpk dhe ti caktoje numeracionin si më poshtë:

I. PËR RRETHET TIRANË, KAVAJË DHE DURRËS:

RRETHI TIRANË:

Nr	Bashkia	Komuna	NDC	Diapazoni i SN		Kapaciteti i alokuar i SN	Konfigurimi i NSN (NDC+SN)
				Fillim	Mbarim		
1.	Tiranë	-----	4	5.300.000	5.303.999	4.000	X YYYYYYY
2	Vorë	-----	47	620.000	620.999	1.000	XX YYYYYY
3	Kamëz	-----	47	240.000	240.999	1.000	XX YYYYYY
4	-----	Dajt	48	980.000	980.999	1.000	XX YYYYYY
5	-----	Bërshullë	47	850.000	850.999	1.000	XX YYYYYY
6	-----	Kashar	48	250.000	250.999	1.000	XX YYYYYY
7	-----	Paskuqan	47	490.000	490.999	1.000	XX YYYYYY
8	-----	Farkë	48	875.000	875.999	1.000	XX YYYYYY

RRETHI KAVAJË :

Nr	Bashkia	Komuna	NDC	Diapazoni i SN		Kapaciteti i alokuar i SN	Konfigurimi i NSN (NDC+SN)
				Fillim	Mbarim		
1.	-----	Golem	578	82.000	82.999	1.000	XXX YYYYY

RRETHI DURRËS :

Nr	Bashkia	Komuna	NDC	Diapazoni i SN		Kapaciteti i alokuar i SN	Konfigurimi i NSN (NDC+SN)
				Fillim	Mbarim		
1.	Durrës	-----	52	600.000	601.999	2.000	XX YYYYYY
2	Shijak	-----	571	70.000	70.999	1.000	XXX YYYYY
3	Sukth	-----	573	80.000	80.999	1.000	XXX YYYYY

Ku: Formati i Numrit Sinjifikativ Kombëtar (NSN) është me 8-shifra, dhe ka konfigurimin e treguar në kolonë, ku shenjat X tregojnë sasinë e shifrave që formojnë NDC (Kodin e Destinimit Kombëtar - *National Destination Code*) dhe shenjat Y tregojnë sasinë e shifrave që formojnë SN (Numrin e Pajtimtarit - *Subscriber Number*).

Formati i numrit për të realizuar thirrje :

- Kombëtare brenda Zonës së Numeracionit - vetëm **SN**
- Kombëtare jashtë Zonës së Numeracionit - **0 + NDC + SN [0 + NSN]**
- Ndërkombëtare: - **00 + CC + NSN**
[ku : CC-Kodi (Prefiksi) i Vendit]

NUMERACIONI I SHKURTUAR

- 0** - Prefiksi per thirrjet kombetare (brenda vendit por jashte zones perkatese te numeracionit)
- 00** - Prefiksi per thirrjet nderkombetare.
- 112** - Numri i urgjences ¹.
- 118** - Rubrika e sherbimeve te Informacionit ².
- 120** - Prenotim i komunikimeve kombetare
- 1211** - Sinjalizim veshtiresish ne komunikimet kombetare.
- 1212** - Sinjalizim veshtiresish ne komunikimet nderkombetare
- 122** - Prenotim i komunikimeve nderkombetare.
- 123** - Njoftim per prishje linje, telefoni.
- 124** - Informacion per numeratorin.
- 126** - Policia Rrugore (*Sherbim Urgjence*) ³
- 127** - Urgjencia mjekesore (*Sherbim urgjence*) ⁴.
- 128** - Zjarrefiksats (*Sherbim urgjence*) ⁵.
- 129** - Policia e rendit (*Sherbim urgjence*) ⁶.
- 1891** - Hapja e kodit kombetar / nderkombetar nga terminale jo-multifrekuence.
- 1892** - Mbyllja e kodit kombetar / nderkombetar nga terminale jo-multifrekuence.

II. Në kategorinë e shërbimit “Thirrje me Karte” (Calling Card) të Planit Kombëtar të Numeracionit i caktohet për përdorim të përhershëm kodi i shkurtër:

¹ . Thirrjet ne kete numer duhet te rrugezohen (direkt ose nepermjet bashkepunimet me sipermarres te tjere te komunikimeve elektronike) ne poste sherbimi qe caktohen ne marreveshje me autoritetet shteterore kompetente te rrethit perkates.

² . Ne vartesi te sasise se sherbimeve te veçanta qe sipermarresi kerkon te identifikojë brenda kesaj rubrike, kodi i shkurter “118” mund te konfigurohet edhe ne formen “118 X..”. Ne kete rast nuk merret miratim ne AKEP, por vetem njoftohet.

³ . Thirrjet ne kete numer duhet te rrugezohen (direkt ose nepermjet bashkepunimet me sipermarres te tjere te komunikimeve elektronike) ne poste sherbimi qe caktohen ne marreveshje me autoritetet shteterore kompetente te rrethit perkates.

⁴ . I njejte me shënimin nr.3.

⁵ . I njejte me shënimin nr.3.

⁶ . I njejte me shënimin nr.3.

(0) 801 535

Ku:

- “0” - prefiksi kombëtar
 - “801” - identifikon Kodin e Aksesit te kategorisë se shërbimit “Thirrje me Karte” i harmonizuar ne nivel kombëtar
 - “535” - Numri identifikues i sipërmarrësit që ofron shërbimin.
2. Ngarkohen Drejtoria e Liçensimit për njoftimin e sipërmarrësit dhe Drejtoritë e tjera te AKEP për ndjekjen e efekteve qe rrjedhin nga ky vendim.
 3. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Ilir SHEHU

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

1. **Afrim TONUZI**
2. **Edlira KASAJ**
3. **Ilir ZELA**
4. **Jetmir KARINI**